



Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-42757, dt. 31.08 2021

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr. 03/ L-040, nenit 34. pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, **Rregullores 12 nr. 320-19338, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017, Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr 12 nr. 400-37743 të datës 03.07.2018, Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2021. Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt. 31.08.2021, miratoi këtë :**

VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e **KH,,Drenica”(M)** Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2021,anëtare e superligës së Hendbollit të Kosovës.

Neni 2.

Projekti i KF,,Feronikeli”(M) përkrahet me shumën prej **2,772.50€** (dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2021.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve , kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten ne konton e **Kh,,Drenica”(M).**Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga **KH,,Drenica”(M)** që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.


Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labirnot Halilaj



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komtunë Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 27.09.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-756/14
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 400-42757 për financimin e projektit Kh "Drenica", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Për:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Trim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Drenasit	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 13.09.2021
Zyrtarët përgjegjës:		Referencë 110/2021
1. Zytari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora, Zytare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
2. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zytare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Ministër z. Krasniqi,
I nderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha.

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendimi Nr. 400-42757 për financimin e projektit Kh "Drenica"</i>
<i>I miratuar më datë 31.08.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.09.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.09.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ komunal, ka synuar ndarjen e mjeteve financiare të kësaj organizate buxhetore për të mbështetur projektin e Kh "Drenica".
2. Në përmbajtje të vendimit të miratuar komunal evidentohet se kategoria e synuar për realizimin e vendimit është kategoria e "subvencioneve dhe transfereve". Rrjedhimisht, analiza vijuese fokusohet në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e vendimit komunal përmes kësaj kategorie.
3. Edhe përkundër faktit se Komuna iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7

Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFPP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfillt të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parashë publike në veçanti.
5. Në kontekst të menaxhimit të mirëfillt të financave publike, paragrafi 2.3 i nenit 2 të LMFPP-së ka përcaktuar se paratë publike mund të shfrytëzohen ose shpenzohen vetëm pasi të jenë ndarë në mënyrë të rregullt sipas këtij ligji.
6. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parashë publike, neni 17 i LMFPP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].

7. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2021, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Drenasit, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
8. Rrjedhimisht, mund të interpretohet se vlera e ndarë për mbulimin e shpenzimeve për "Kh Drenica", mund të financohet dhe/apo realizohet nga ndarja buxhetore e theksuar me aktin administrativ komunal.
9. Si pikë e fundit, si dhe duke konsideruar që shqyrtimi i aktit komunal nuk reduktohet vetëm në shumën e ndarë për financim, Ministria e ka verifikuar statusin e "Kh Drenica" në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ). Sipas të dhënave në këtë sistem, "Kh Drenica" është e regjistruar si Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ).
10. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislativë të Ministrisë evidentohej si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
11. Në rastin konkret, dhe konform nenit 2, nën-paragrafit 5.2 të kësaj Rregullore, vlera e ndarë për financim nuk tejkalon shumën prej dy për qind (2%) të ndarjes totale buxhetore në kuadër të kodit/programit buxhetor për vitin 2021. Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore nuk janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!